



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0465

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “MetBat” SH.P.K. kundër Vendimit për dhënie të një kontrate të Komuna e Rahovecit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Asgjesimi i Mbetjeve Medicinale dhe i barnave pa afat - Ritenderim” me nr. të prokurimit: “623-24-2530-2-2-1”, me 22/07/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “MetBat” SH.P.K. me nr. 2024/465, e datës 30/05/2024, kurse vendimi për dhënie të një kontrate të Komuna e Rahovecit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Asgjesimi i Mbetjeve Medicinale dhe i barnave pa afat - Ritenderim” me nr. të prokurimit: “623-24-2530-2-2-1”, mbetet në fuqi.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “MetBat” SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 19.03.2024, Komuna e Rahovecit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Asgjesimi i Mbetjeve Medicinale dhe i barnave pa afat - Ritenderim” me nr. të prokurimit: “623-24-2530-2-2-1”. Ndërsa me datën 20.05.2024 ka publikuar Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka vazhduar me aktivitetin e prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbime dhe me vlerë të parashikuar të kontratës për 46,000.00 €.

Me 20.05.2024, OE “MetBat” SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 20.05.2024, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 30.05.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “MetBat” SH.P.K. me nr. 465/2024 për lidhur me aktivitetin “Asgjesimi i Mbetjeve Medicinale dhe i barnave pa afat - Ritenderim” me nr. të prokurimit: :“623-24-2530-2-2-1”.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “MetBat” SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi ankimor 1

Pretendimi kryesor ankimorë sipas ankesës 465/24, ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues nga AK-KK Rahovec, ku sipas të njëjtit OE ankues nuk plotëson kërkesën e dosjes së tenderit Sipas AK-së OE ankues ka ofruar leje të integruar mjedisore e cila nuk plotëson kërkesën e AK-së për Licencë për grumbullimin dhe asgjësimin e mbeturinave medicinale e cila lëshohet mbi bazën e ligjit nr.04/L-060, ndërsa leja ofruar nga OE ankues është lëshuar mbi bazën e Ligjit nr.03/L-043.

Më konkretisht **AK** në arsyetim të refuzimit të përgjigjes të kërkesës për rishqyrtim pohon se : *“...Oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme pasi që nuk e plotëson kërkesën e Dosjes së Tenderit dhe të Njoftimit për kontratë, për faktin se keni ofruar Leje Mjedisore të Integruar të lëshuar mbi bazën e Ligjit nr.03/L-043, për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes, i cili ka për qëllim krijimin e standardeve mjedisore për parandalimin e ndotjes, ndërsa AK-ja, në rastin konkret ka kërkuar Licencë e cila lëshohet mbi bazën e Ligjit nr.04/L-060 për mbeturina, që ka të bëjë me menaxhimin e mbeturinave duke përfshirë edhe ato medicinale. Pra, në rastin konkret AK-ja, ka kërkuar Licencë dhe jo leje mjedisore, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së; Për këtë qështje është edhe Vendimi i OSHP-së me Nr.: 311/23; Vendimi i OSHP-së me Nr.: 534/22...”*

OE ankues pretendon se leja të cilën ka ofruar i njëjti është ekuivalente me atë çka është kërkuar nga AK.

OE ankues pretendon se kjo është vërtetuar edhe përmes ekspertizës 249/23 të ekspertit shqyrtues dhe vendimit të OSHP-së 536/23.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, OSHP me datë 07.06.2024 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 465/2024, ndërsa me datë 21.06.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2024/465 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues pajtohet ne lidhje me raportin e ekspertit, Ndërsa OE nuk pajtohet lidhur me rekomandimin e ekspertit.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “MetBat” SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0465 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): Eksperti pas analizimit të ankesës, dosjes së tenderit dhe përgjigjes së AK-së në kërkesë për rishqyrtim, bazuar në pretendimet e OE ankues si dhe atyre të AK-së i jemi referuar vendimeve të OSHP-së të potencuara nga të dyja palët. Pas analizimit të ekspertizës 249/23 për të cilën siç pretendon se OE ankues se eksperti i ka konsideruar ekuivalente licencën dhe lejen, në vazhdim kemi gjetur se vendimi i OSHP-së me të njëjtin numër 249/23 ka konstatuar të kundërtën. Më konkretisht OSHP përmes vendimit 249/23 ka refuzuar ankesën e OE të njëjtë “Metbat” dhe atë për situatë identike si kjo që gjendemi tani. Përveç kësaj edhe me vendimet 311/23 dhe 69/23 këtë problem e ka trajtuar në këtë mënyrë. Vendimi 536/23 të cilit i referohet OE ankues ku është aprovuar ankesa e OE ankues, ka qenë për ankesë në kritere, ku OE ka obliguar AK-së të korrigjoj dosjen dhe përveç licencës të lë lejohet edhe Leja mjedisore.

Pas gjitha këtyre që u cekën më lart, fillimisht sqarojmë se në rastin konkret ankesa nuk është bërë në kritere, por në vlerësim të ofertave, andaj në pajtim me vendimet dhe praktikat e mëhershme të OSHP-së sipas vendimeve të OSHP-së të cekura më lart, vlerësojmë se vendimi i AK-së është në pajtim me kërkesat e dosjes, dhe se pretendimet ankiomore janë vetëm pjesërisht te bazuara dhe çështja e Licencës/Lejes është dashur te ngritetet si çështje ne fazen para ofertimit ne pajtim me nenin 108/A par.3.1 te LPP-se lidhur me nenin 60.1 te Rregullores 001-2022 per Prokurim Publik.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertëve shqyrtues profesional dhe teknik, lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e neni 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim

të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues profesional, lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në këtë kontest me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Në këtë rast Paneli Shqyrtues i mbështet përgjigjet e ekspertit shqyrtues profesional për shkak se eksperti shqyrtues profesional sipas vlerësimit të panelit ju është përgjigjur pretendimeve ankimore ashtu sikurse është përcaktuar edhe me nenin 113 dhe 114 të LPP. Për më tepër lidhur me këto pretendime veç OSHP ka gjykuar disa herë për këto pretendime të ngritura. Në fakt, ligjvënësi tek neni 108/A të LPP, e ka paraparë se ankesat mund të paraqiten në dy raste, ndaj njoftimit për kontratë që do të thotë në fazën para ofertimit dhe rasti tjetër pas njoftimit për dhënie të kontratës. Në fazën e para ofertimit çdo palë e interesuar nëse ka interes që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit dhe konsideron se kërkesat e vendosura nuk janë relevante dhe janë diskriminuese si dhe specifikacionet teknike nuk janë konform nenit 28 dhe hartimi i dosjes së tenderit nuk është konform nenit 27 të LPP, atëherë mund të paraqes kërkesë për rishqyrtim në AK dhe pastaj ankesë në OSHP, ndërsa, në këtë rast ankesa është paraqitur në fazën e dhënies së kontratës, me çrast ankuesi i ka pranuar të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit me rastin e ofertimit të tij në këtë aktivitet të prokurimit. Si rrjedhojë, paneli shqyrtues konstaton edhe përmes platformës së eprokurimit se ankuesi para fazës së ofertimit nuk ka paraqitur asnjë ankesë në AK apo në OSHP, për këtë aktivitet të prokurimit, që do të thotë se i ka pranuar kërkesat dhe kushtet e ofertimit dhe për të njëjtat edhe ka ofruar çmime, Kjo konfirmohet edhe me Formularin e Dorëzimit të Ofertës, ku përmes këtij formulari ka deklaruar se i ka kontrolluar dhe pranon të gjitha kushtet e tenderit dhe dorëzon ofertën e tij financiar. E në fakte ky Formular sipas nenit 17.7 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimit Publik është pjesa kryesore e ofertës. Fakt ky që për ankuesi ka qenë i njohur në bazë të shumë vendimet të nxjerrura nga OSHP, po ashtu, vlenë të theksohet se për ankuesi e gjitha kjo e cituar më lartë ka qenë e njohur sepse njëjti ka paraqitur ankuesi ankesën e tij me Nr. 2023/0536 për një aktivitet tjetër, ankesë kjo e cila është paraqitur para se të ofertohej.

Andaj, Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional dhe në konsistencë edhe me vendimet tjera ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues në mungesë të ndonjë prove rreth papërgjegjshmërisë së OE të rekomanduar për kontratë ka vendosur ta lejë në fuqi vendimin e AK. Vendim ky i cili mban përgjegjësi sipas nenit 59.1 të LPP. Duke u nisur edhe

nga fakti se AK gjatë vlerësimit të ofertave duhet të veprojnë konform nenit 59.4 të LPP, i cili citon: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.”

Andaj, sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP, Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj.

Pa nevojë për analiza tjera, OSHP niset gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitetet buxhetore mirëpo AK duhet të kujdeset ex-officio edhe për parimet bazë të LPP-së dhe gjatë hartimit të kriterëve të dosjes së tenderit të mos hartojë specifikime teknike që bien ndesh me dispozitat e LPP-së.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**
- **OE - MetBat SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: